

L I GJ

Nr.8374, datë 15.7.1998

**PËR PËRDORIMIN E HAPËSIRËS AJRORE TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Objekti

Ky ligj ka për qëllim përcaktimin dhe rregullimin ligjor të përdorimit të hajrore të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me interesat kombëtarë e me rinderkombëtarë.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë ligj, nëse nuk përcaktohet ndryshe, me termat e mëposhtëm do të ku Me "DPAC" kuptojmë Drejtorinë e Përgjithshme të Avacionit Civil, i cili është aeronautik shqiptar, në varësinë e ministrit që mbulon veprimtarinë në fushën e trans-

Me "aviacion shtetëror" kuptojmë avionët e përdorur për shërbime qeveri ushtrisë, të policisë, të doganës dhe të shëndetësisë.

Me "hapësirë ajrore" kuptojmë atë pjesë të hapësirës që shtrihet mbi tokën dh territorialë nën sovranitetin e Republikës së Shqipërisë.

Me "aviacioni civil" kuptojmë tërë avacionin, me përjashtim të atij ushtarak "Aviacioni ushtaraku" është avioni që i shërben mbrojtjes së vendit.

Me "hapësirë të kontrolluar" kuptojmë hapësirën me përmasa të përcaktuara, në të cilën shërbimi i kontrollit të trafikut ajror është siguruar si për fluturimet instrumentale (IFR), edhe për fluturimet vizuale (VFR), në përputhje me klasifikimin e hapësirës.

Me "zonë të rrezikshme" kuptojmë hapësirën me përmasa të përcaktuara, në të cilën veprimtaria e avacionit në fluturim mund të rrezikohet në një kohë të caktuar.

Me "zonë të ndaluar" kuptojmë hapësirën me përmasa të përcaktuara në tokën ose ujërat territoriale të një shteti, në të cilën fluturimi i avionit është i ndaluar.

Me "zonë të kufizuar" kuptojmë hapësirën me përmasa të përcaktuara, në tokën ose në ujërat territoriale të një shteti, në të cilën fluturimi i avionit është i kufizuar, për shkak të kushteve specifike.

Me "trafik ajror" kuptojmë të gjithë avionët që janë në fluturim ose që operojnë në zonën lëvizëse të një aerodromi.

Me "mjetet e udhëtimit ajror" kuptojmë mjetet e përshtatshme për transportimin e personave dhe të sendeve në ajër, pa lidhje mekanike me tokën, pavarësisht nese janë më të rendë se ajri (p.sh. aeroplanët, planeret, helikopterët dhe parashuta) ose më të lehtë se ajri (aerostatet dhe balonat).

Me "zonë stërvitjeje" kuptojmë hapësirën ajrore, të kufizuar nga të gjitha anët, ku lejohet komandimi në fluturim i mjeteve të udhëtimit ajror nga persona që nuk janë të pajisur më dokumentin e pilotit.

Me "zonë prove" kuptojmë hapësirën ajrore, të kufizuar nga të gjitha anët, në të cilën lejohet përdorimi në fluturim i mjeteve të udhëtimit ajror pa leje udhëtimi.

Me "aeroportet" kuptojmë një aerodrom publik, i cili është i caktuar për qarkullimin ajror ndërkombëtar dhe është i pajisur me instalimet e domosdoshme për këtë veprimtari.

Me "fushë fluturimi" kuptojmë një aerodrom civil, i cili nuk është aeroport.

Me "aerodrom" kuptojmë një zonë të përcaktuar mbi tokë ose në ujë (përfshi ndërtesat, instalimet dhe mjetet) që të jetë e përdorshme, tërësisht ose pjesërisht, për uljen, ngritjen dhe lëvizjen në sipërfaqe të avionit.

Neni 3

Liria e përdorimit të hapësirës ajrore

Përdorimi i hapësirës ajrore nga mjetet e udhëtimit ajror dhe nga aparatet e avacionit në fluturim është i lirë, derisa nuk përcaktohet ndryshe nga ky ligj.

Neni 4

Hapësira e kontrolluara, në përputhje me kërkesat e sigurisë së qarkullimit, klasifikohen dhe përcaktohen sipas procedurave të veçanta në këto hapësira, me udhëzim të përbashkët të ministrit që mbulon veprimtarinë në fushën e transportit dhe ministrit të Mbrojtjes.

Neni 5

Detyrat për shërbim të shpejtë dhe për sigurinë e trafikut ajror dhe kryesisht lidhur me lëvizjet e mjeteve ajrore në hapësirën ajrore dhe në tokë dhe me lartësitë që duhen respektuar në fluturim përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon veprimtarinë në fusinë e transportit.

Neni 6

Kufizimet në hapësirën ajrore

DPAC-ja, nëpërmjet publikimeve aeronautike, njofton për hapësirat e kufizuara gjitha anët, kufizimet e poshtëshënuara:

- a) Ndalimi i fluturimit nëpër këto zona (zonë ajrore e ndaluar);
- b) lejimi i fluturimit nëpër këto zona vetëm me kufizime të caktuara (zonë e kufizuar);
- c) njoftimi që fluturimi në këto zona paraqet rrezik (zonë e rrezikshme).

Neni 7

Zonat me hapësirë ajrore të kufizuar duhen të përcaktohen në mënyrë të tillë që këto zonat tregojnë përpjekje të shenjat dalluese të terrenit, të cilat mund të perceptohen lehtë nga kufizimi i sipërm i zonës ajrore të kufizuar duhet të shprehet me një sipërfaqe horizontale absolute e së cilës duhet të jetë në barazim me lartësinë mbi nivelin e detit. E njihet se vlen dhe përsipërfaqen kufizuese nga poshtë, nëse nuk orientohet nga sipërfaqja e tolës së cilës nuk përpjekje të kufizuar.

Neni 8

Kompetencat për përcaktimin dhe përkufizimin në hapësirën ajrore

Kufizimet në hapësirën ajrore të përmendura në nenin 6 të këtij ligji përkufizim i "b", si dhe për zonat e rrezikshme pika "c", përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ngritur që mbulon veprimtarinë në fushën e transportit, të ministrit të Mbrojtjes dhe të ministrave të ministrat e përgjegjësve, kur janë:

- a) në interes të sigurisë së udhëtimit ajror;
- b) për të shmangur efektet shqetësuese të avionave ndaj personave ose objekteve të tjera;
- c) për sigurimin e veprimeve të kërkim-shpëtimit;
- ç) për ruajtjen e qetësisë publike, të rendit dhe të sigurisë.

Neni 9

Ministri i Mbrojtjes duhet të përcaktojë për sa kohë që në nenin 8 nuk është përkufizim i "b", si dhe për zonat e kufizuar të hapësirës ajrore, kur një gjë të tillë e kërkon angazhimit e mbrojtjen e sovranitetit ajror.

Neni 10

Zonat ajrore të kufizuar, sipas nenit 9 të këtij ligji, mund të caktohen nga ministri i Mbrojtjes për një afat kohor 15-ditor. Zgjatja e këtij afati bëhet me miratim të Këshijës së Mbrojtjes.

Neni 11

Njoftimi i kufizimeve së hapësirës ajrore

Udhëzimet e përmendura në nenet 8, 9, dhe 10 të këtij ligji, si dhe udhëzimet për zonat me rreziqe, bëhen të njohura nëpërmjet publikimeve aeronautike të DPAC-së.

Neni 12

Hapësirat ajrore për stërvitje dhe për prova

Zonat e nevojshme për avionin civil, për stërvitjen dhe provat, duke marrë parasysh interesat publike, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit që mbulon veprimtarinë në fushën e transportit dhe të ministrit të Mbrojtjes.

Neni 13

Zonat e nevojshme për avionin ushtarak, për stërvitjen dhe provat, duke marrë parasysh interesat e mbrojtjes së vendit, si dhe interesat e tjera publike, përcaktohen me udhezim të përbashkët të ministrit të Mbrojtjes dhe të ministrit që mbulon veprimtarinë në fushën e transportit.

Neni 14

Përdorimi i hapësirës ajrore shqiptare

Hapësira ajrore e Republikës së Shqipërisë mund të jetë në përdorim nga një avion, që:

- ka një stemë dhe një regjistrim ose një tjetër përshkrim legal të shenjës identifikuese;
- pilotohet nga një person i pajisur me leje, të lëshuar nga DPAC-ja ose nga autoriteti ushtarak i avionit. Bën përjashtim pilotimi i avionit nga një kursant gjatë periudhës stërvitore.

Neni 15

Avionët e huaj civilë mund ta përdorin hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë ose, në mungesë të tyre, më një leje të lëshuar më parë nga DPAC-ja.

Neni 16

Fluturimi brenda vendit dhe dalja nga hapësira ajrore e tij është e lejueshme në dy raste:

- drejt ose prej aeroporteve ku Republika e Shqipërisë është palë;
- drejt ose prej fushave të fluturimit.

Fushat drejt ose nga të cilat mund të kryhen fluturime me jashtë, si dhe procedurat që duhen respektuar gjatë këtyre fluturimeve përcaktohen nga ministri që mbulon veprimtarinë në fushën e transportit.

Neni 17

Fluturimet për jashtë drejt fushave të fluturimit lejohen vetëm kur avioni fose ngrihet prej një aeroporti, ku dogana, kontrolli i pasaportave, policia dhe siguri janë funksionale.

Neni 18

Kërkesat e sigurimit publik dhe të mbrojtjes së vendit për rastet dhe pëi jepet miratimi nga DPAC-ja për fluturimin brenda dhe jashtë vendit, si dhe pë nepër hapësirën ajrore, pa ulje, apo për përjashtimin e fluturimeve të shprehura pika "a" e këtij ligji, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit që mbulon në fushën e transportit, të ministrit të Rendit Publik, të ministrit të Mbrojtjes dhë të Financave.

Neni 19

DPAC-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, përderisa në këtij ligji nuk është përcaktuar ndryshe, jep miratimin për fluturimet e avionëve të hu në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë.

Neni 20

DPAC-ja, në bashkëpunim më Ministrinë e Mbrojtjes, jep miratimin për avionëve të huaj ushtarakë në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë.

Neni 21

Taksat për përdorimin e hapësirës ajrore shqiptare

Taksat për përdorimin e hapësirës ajrore shqiptare përcaktohen me ligj.

Neni 22

Përdorimi i paautorizuar i hapësirës

Çdo avion që hyn dhe që përdor i paautorizuar hapësirën ajrore shqiptare i i nga avionët e rojes luftarake.

Neni 23

Çdo avion i interceptuar duhet të ndjekë instruksionet ose shenjat për u kohë. Avioni që nuk i bindet thirrjes, në varësi të situatës, mund të detyrohe përputhje me sovranitetin kombëtar dhe në përputhje me konventat ndërkombëtar

Neni 24

Procedurat që ndiqen për rastin e përdorimit të paautorizuar të hapësirës ajrore shqiptare, në përputhje me vendimet e Këshillit të Mbrojtjes, percaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Mbrojtjes, të ministrit që mbulon veprimtarinë në fushën e transportit dhe të ministrit të Rendit Publik.

Neni 25

Neni 10 dhe neni 11 i dekretit nr.4650, datë 9.3.1970 "Për kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë", si dhe çdo akt tjeter që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 26

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet përkatëse në bazë dhe për zbatim të këtij ligji.

Neni 27

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2170, datë 28.7.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani